



QARKU I DIASPORËS QV nr. _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
FLETË VOTIMI
Zgjedhjet për Kushtetut e Shqipërië, 11 Maj 2025



1

PARTIA X

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15

Kandidatit sipas numrave

2

PARTIA Y

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15

Kandidatit sipas numrave

VOTA E DIASPORËS: KUTIA E PANDORËS?

RAPORT MONITORIMI

Dhjetor 2024

QENDRËSA QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
LORELA ALIA

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	3
METODOLOGJIA	4
VOTA E DIASPORËS: KUADRI LIGJOR.....	5
ASPEKTET HISTORIKE, EKONOMIKE DHE SOCIAL TË DIASPORËS SHQIPTARE.....	6
NDIKIMI I VOTËS SË DIASPORËS NË PARTITË POLITIKE DHE SISTEMIN ZGJEDHOR.....	8
PARTITË POLITIKE NË GARË PËR VOTËN E DIASPORËS PËR ZGJEDHJET E 2025 12	
GJETJET KRYESORE.....	14
REKOMANDIME.....	15
REFERENCA	17



1. HYRJJE

Emigrimi ka qenë një dukuri e vazhdueshme në Shqipëri që nga vitet '90, duke arritur nivele të larta që vazhdojnë edhe sot. Shkak kryesor për këtë fenomen është mungesa e përmbushjes së nevojave bazike të qytetarëve. Ky emigrim ka pasur ndikime të thella sociale dhe ekonomike, duke u manifestuar si "brain drain" nga njëra anë dhe si kontribues në ekonomi përmes remitancave nga ana tjetër.

Sipas INSTAT, numri i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit ka arritur në rreth 1.64 milionë, duke përbërë 57% të popullsisë brenda vendit, e cila aktualisht është rreth 2.87 milionë banorë.¹ Megjithëse diaspora shqiptare ka një peshë të konsiderueshme demografike, historikisht ajo ka qenë e privuar nga e drejta e saj kushtetuese për të votuar nga shteti ku ajo është e pozicionuar. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e mosmarrëveshjeve dhe përplasjeve politike midis dy partive kryesore, si dhe vonesave institucionale.

Procesi i garantimit të së drejtës së votës për diasporën ka kaluar një rrugë të gjatë dhe të vështirë. Ndër momentet më të rëndësishme ishte vendimi i Gjykatës Kushtetuese në dhjetor 2022, i cili konstatoi cënimin e së drejtës kushtetuese të votës së diasporës, si dhe miratimi i akteve plotësuese nga Parlamenti në vitin 2024. Pas viteve të gjata diskutimesh dhe përplasjeve politike, diaspora do të ketë mundësinë të votojë për herë të parë në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025. Kjo arritje u mundësua falë dakordësimit midis dy partive kryesore dhe reformës zgjedhore të miratuar nga Parlamenti, i cili plotësoi kuadrin ligjor për votën e diasporës.²

Vota e diasporës përfaqëson një mekanizëm kyç për përfaqësim demokratik dhe një urë lidhëse midis shqiptarëve jashtë vendit dhe zhvillimeve politike e sociale në Shqipëri. Megjithatë, sfidat praktike mbeten të shumta, duke përfshirë aspektet teknike, afatet kohore, sigurinë e procesit të votimit dhe numërimin e votave.

Në përgjithësi, opinioni publik shqiptar e percepton votën e diasporës si një mundësi për të ndikuar pozitivisht në emancipimin politik dhe përmirësimin e klimës politike në vend. Pjesa më e madhe e shqiptarëve që jetojnë jashtë ndodhen në vende me demokraci të zhvilluar dhe të konsoliduar dhe ky fakt pritet të reflektohet në orientimin e votës së tyre përgjatë zgjedhjeve parlamentare në

¹ Popullsia. (n.d.). Instat. <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>

² Qbz - Qendra e Botimeve Zyrtare. <https://qbz.gov.al/preview/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>

Shqipëri. Për më tepër, përfshirja e diasporës në procesin politik mund të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit qytetar dhe adoptimin e praktikave më të mira demokratike.

Ky raport synon të analizojë rëndësinë dhe ndikimin që vota e diasporës mund të ketë mbi politikën shqiptare, si dhe çfarë do të sjellë në debatin publik.

Qëllimi i studimit: Të analizojë se si pjesëmarrja e diasporës mund të ndryshojë dinamikat politike dhe shoqërore në Shqipëri.

Pyetja kryesore e hulumtimit: “Si mund pjesëmarrja e diasporës të sjellë një perspektivë të freskët dhe të kontribuojë në ndryshimin e dinamikave të debatit politik shqiptar?”

2. METODOLOGJIA

Ky raport do të ndjekë një kombinim të analizës cilësore dhe sasiore.

Analiza Cilësore

- **Kuptimi i sfidave dhe perceptimeve mbi procesin e votimit**
Kjo pjesë do të fokusohet në identifikimin e sfidave që lidhen me votën e diasporës, përfshirë pengesat logjistike, ligjore.
- **Studim mbi ndikimin e votës së diasporës në politikën shqiptare**
Analiza do të hulumtojë mënyrën se si përfshirja e votës së diasporës mund të ndikojë në vendimet politike dhe prioritetet kombëtare. Ky studim do të trajtojë ndryshimet e mundshme në diskursin politik dhe freskinë që sjell përfshirja e diasporës në skenën politike shqiptare.

Analiza Sasiore

- **Analizë e të dhënave statistikore mbi regjistrimin e votuesve jashtë vendit si dhe pjesëmarrjen në proceset zgjedhore të mëparshme**
Kjo pjesë do të përfshijë grumbullimin dhe analizimin e të dhënave mbi:
 - Numrin e shqiptarëve të regjistruar për të votuar jashtë vendit.
 - Shkallën e pjesëmarrjes së tyre në proceset zgjedhore të mëparshme.

**VOTA E DIASPORËS:
KUTIA E PANDORËS?**

Burimet e të Dhënave:

- **Të Dhëna Dytësore:**

- Dokumente ligjore dhe rregullore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).
- Raporte të organizatave ndërkombëtare si OSBE dhe ODIHR mbi proceset zgjedhore dhe votimin e diasporës.

Kjo metodologji synon të ofrojë një pasqyrë të gjithanshme për të kuptuar sfidat dhe mundësitë që ofron implementimi i votës së diasporës, duke shërbyer si bazë për rekomandime të qarta dhe të zbatueshme.

3. VOTA E DIASPORËS: KUADRI LIGJOR

Kushtetuta e Shqipërisë garanton të drejtën për të votuar për të gjithë shtetasit shqiptarë, pavarësisht vendndodhjes së tyre. Kjo e drejtë përfshin edhe diasporën shqiptare, por realizimi praktik ka përballur sfida të shumta në aspektet ligjore, logjistike dhe teknike. Për vite me radhë, diaspora ka kërkuar të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje, duke intensifikuar përpjekjet sidomos pas rritjes së ndjeshme të migrimit pas viteve 2000.³

Një moment kyç për këtë çështje ishte reforma zgjedhore e vitit 2020. Përmes kësaj reforme, Kuvendi i Shqipërisë përcaktoi se shqiptarët që jetojnë jashtë vendit do të kenë mundësinë të votojnë nga vendet ku ndodhen. Ky vendim u përshëndet si një hap i rëndësishëm për demokratizimin dhe përfshirjen e qytetarëve në procesin zgjedhor. Megjithatë, sfidat për zbatimin e këtij vendimi mbeten të mëdha. Gjykata Kushtetuese, në një vendim të mëvonshëm, rikonfirmoi rëndësinë e kësaj të drejte dhe nxiti përshpejtimin e procesit për zbatimin e saj, duke theksuar nevojën për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare në këtë drejtim.

Ligji nr. 81/2024 krijoi një kornizë të qartë ligjore për votën e diasporës, duke parashikuar procesin e regjistrimit, dërgimin e fletëve të votimit dhe administrimin e procesit zgjedhor.⁴ Ky ligj ngarkon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me përgjegjësinë për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit, duke përfshirë miratimin e akteve nënligjore dhe garantimin e transparencës. Një hap thelbësor në këtë drejtim është krijimi i Platformës Elektronike të Regjistrimit (PER), e cila synon të thjeshtësojë procedurat për zgjedhësit jashtë vendit.

³ QBZ - Qendra e Botimeve Zyrtare. <https://qbz.gov.al/preview/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>

⁴ LIGJ Nr. 10 019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Procesi i regjistrimit nis 120 ditë përpara zgjedhjeve dhe përfundon 60 ditë më parë, duke kërkuar që qytetarët të dorëzojnë dokumentacion që dëshmon qëndrimin e tyre jashtë Shqipërisë. Regjistrimi i saktë dhe në kohë mbetet sfidë për shkak të ndërlikimeve të mundshme logjistike dhe mungesës së informacionit për shumë shtetas.⁵

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është dërgimi i fletëve të votimit dhe kthimi i tyre. Neni 25/1, pika 3, i Kodit Zgjedhor përcakton që këto fletë dërgohen përmes shërbimit postar, me shpenzimet e zgjedhësit. Megjithatë, më 8 janar 2025, KQZ njoftoi se shteti shqiptar do të mbulojë kostot për kthimin e fletëve të votimit të diasporës. Kjo është një masë e rëndësishme për të lehtësuar pjesëmarrjen, por ndryshimi ende nuk reflektohet në Kodin Zgjedhor, duke krijuar pasiguri ligjore. Është e domosdoshme që këto ndryshime të formalizohen ligjërisht për të garantuar stabilitetin dhe besueshmërinë e procesit zgjedhor dhe për të shmangur ndërhyrjet e mundshme të palëve të interesuara.⁶

Procesi i votës së diasporës është një hap thelbësor drejt forcimit të lidhjeve mes Shqipërisë dhe qytetarëve të saj që jetojnë jashtë vendit, duke kontribuar në demokratizimin dhe përfshirjen më të madhe të tyre në jetën politike kombëtare. Megjithatë, sfidat që lidhen me ndërgjegjësimin, përmirësimin e infrastrukturës dhe sigurimin e standardeve të votimit kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe angazhim institucional.

4. ASPEKTET HISTORIKE, EKONOMIKE DHE SOCIAL TË DIASPORËS SHQIPTARE

Sipas të dhënave të INSTAT, numri i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit ka arritur në rreth 1,64 milion banorë, që përfaqëson gati 57% të popullsisë që jeton brenda vendit, aktualisht rreth 2,76 milion banorë.⁷ Ky emigrim masiv ka ndikuar thellë në strukturën demografike dhe ekonomike të Shqipërisë, duke u shfaqur si një proces i dyanshëm: nga njëra anë si “brain drain” dhe nga ana tjetër si kontribues ekonomik përmes remitancave.

Diaspora shqiptare ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në ekonominë e vendit. Remitancat që transferohen nga shqiptarët

⁵ KQZ. (2023, April 3). Rregullat për Votimin nga Jashtë - KQZ. KQZ - Komisioni Qendror I Zgjedhjeve. <https://kqz.gov.al/rregullat-per-votimin-nga-jashte/>

⁶ Speciale/ Zgjedhjet 2025, ja si do regjistrohet një emigrant për të votuar! Celibashi për Report Tv: Qeveria 5 mln euro për të paguar postën, por duhet ndryshuar Kodi. (2025, January 2). Shqiptarja.com. <https://shqiptarja.com/index.php/laim/speciale-zgjedhjet-2025-hap-pas-hapi-si-te-regjistrohet-nje-emigrant-per-te-votuar-celibashi-per-report-tv-nuk-do-paguajne-asnie-kosto>

⁷ Popullsia. (n.d.). INSTAT. <https://www.instat.gov.al/al/temat/trequesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>


jashtë vendit përfaqësojnë një burim kryesor të ardhurash, duke ndihmuar familjet për të përballuar jetesën e përditshme dhe duke kontribuar në konsumin e brendshëm. Në vitet e fundit, remitancat kanë zënë një peshë të konsiderueshme në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë, duke ndikuar pozitivisht në stabilitetin ekonomik të vendit. Ato mbeten një nga kontribuesit kryesorë në ekonominë shqiptare, duke siguruar një rrjedhë të qëndrueshme të ardhurash nga diaspora dhe duke mbështetur ekonominë kombëtare në periudha sfiduese. Në vitin 2023, dërgesat e emigrantëve arritën në **930 milionë euro**, duke shënuar një rritje prej **11.3%** krahasuar me vitin e mëparshëm.⁸ Ky tregues reflekton rolin në rritje të remitancave si burim i stabilitetit financiar për familjet dhe ekonominë shqiptare.

Sipas të dhënave të **Trading Economics**, remitancat në Shqipëri arriten në **268.04 milionë euro** në tremujorin e dytë të 2024.

Rritja e remitancave përgjatë 10 viteve të fundit dhe qëndrueshmëria e tyre përfaqësojnë një shtyllë thelbësore të ekonomisë shqiptare, duke mbështetur konsumin dhe zhvillimin ekonomik.⁹ Për të siguruar që ky burim i rëndësishëm të vazhdojë të kontribuojë pozitivisht, qeveria duhet të zbatojë politika që inkurajojnë rrjedhjen e remitancave dhe angazhimin më të madh të diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit.

Grafiku 1. Remitancat e Shqipërisë 2015-2023

AL Remittances - EUR Million



Burimi: Trading Economics

⁸ TRADING ECONOMICS. (n.d.). Albania remittances. <https://tradingeconomics.com/albania/remittances#:~:text=Remittances%20in%20Albania%20decreased%20to,the%20second%20quarter%20of%202024.>

⁹ TRADING ECONOMICS. (n.d.). Albania remittances. <https://tradingeconomics.com/albania/remittances#:~:text=Remittances%20in%20Albania%20decreased%20to,the%20second%20quarter%20of%202024.>

Megjithatë, largimi masiv i të rinjve të arsimuar ka krijuar një boshllëk në tregun e punës dhe ka shkaktuar humbje të burimeve njerëzore të kualifikuara. Ky fenomen rrezikon të kufizojë potencialin afatgjatë të zhvillimit ekonomik. Investimet publike dhe private në arsimimin e këtyre të rinjve nuk po japin rezultatet e pritura në ekonomi, pasi ata kontribuojnë në vendet pritëse dhe jo në Shqipëri. Si pasojë, reduktimi i fuqisë puntore të kualifikuar mund të ulë konkurrueshmërinë e vendit dhe të rrisë varësinë nga importet.

Aspekti Social dhe Politik

Diaspora shqiptare ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në aspektet sociale dhe politike. Ndër vite, ajo ka ofruar mbështetje për kauza të ndryshme kombëtare dhe ka ruajtur lidhjet me vendin e origjinës përmes vizitave të rregullta dhe aktiviteteve të ndryshme. Ky angazhim tregon lidhjen e fortë emocionale dhe kulturore të diasporës me Shqipërinë.

Në aspektin politik, diaspora ka kërkuar me vendosmëri përfshirjen në proceset zgjedhore të Shqipërisë. Votimi i diasporës përfaqëson një të drejtë kushtetuese dhe një hap të rëndësishëm drejt një demokracie më gjithpërfshirëse. Me një numër kaq të madh qytetarësh që jetojnë jashtë, ndikimi i tyre në proceset politike të vendit do të jetë i konsiderueshëm, sidomos në orientimin e votës drejt vlerave dhe standardeve europiane.

5. NDIKIMI I VOTËS SË DIASPORËS NË PARTITË POLITIKE DHE SISTEMIN ZGJEDHOR

Procesi i regjistrimit të votuesve të diasporës për zgjedhjet e ardhshme parlamentare ka shënuar një interes të konsiderueshëm. Në 10 ditët e para, rreth 50,000 votues janë regjistruar në platformën përkatëse.¹⁰ Ky numër përfaqëson një rritje progresive, duke pasur parasysh se është hera e parë që diaspora shqiptare do të ketë mundësinë të votojë. Megjithatë, procesi është ndikuar nga vendimi i vonuar për miratimin e rregulloreve ligjore dhe fushata e kufizuar e informimit, për shkak të afateve të zgjatura dhe paqartësive mbi aspektet procedurale. Nëse ritmi aktual i regjistrimit vazhdon deri më 4 mars, data e përfundimit të procesit, numri total i votuesve të regjistruar mund të arrijë deri në 300,000.

¹⁰ Statistikat e Përdorimit. (n.d.). <https://kaz.al/stats/>

Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 ishte 1,662,274 votues, ndërsa në zgjedhjet lokale të vitit 2023, kjo shifër ra në 1,395,645 votues.¹¹

Tab. 1 Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021

Subjekti	Numri i Votave
Partia Socialiste (PS)	768,250 vota
Partia Demokratike " Aleanca për Ndryshim " (PD - AN)	622,265 vota
Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	107,533 vota

Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Duke marrë në konsideratë këto shifra, vota e diasporës pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e fituesit të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Për të pasur një tablo më të qartë mbi impaktin e votës së diasporës, do të realizojmë një analizë si në terma afatshkurtër po ashtu edhe afatgjatë të kësaj vote.

a) Në terma afatgjatë

Përtej përfitimeve ekonomike nga remitancat, diaspora shqiptare ka një ndikim të thellë social dhe politik. Emigrantët shqiptarë, të vendosur kryesisht në vendet e Evropës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë të ekspozuar ndaj sistemeve demokratike të zhvilluara dhe institucioneve të pavarura. Si rezultat, ky ekspozim ka gjasa të ndikojë në sjelljen e tyre zgjedhore, duke i bërë më kritikë ndaj klasës politike shqiptare.

Një element i rëndësishëm për t'u theksuar është tendenca që vota e diasporës në rajon të shihet si një "votë proteste" kundër klasës së vjetër politike. Ky fenomen është vërejtur edhe në vende si Kosova, ku emigrantët shpesh votojnë për alternativa të reja politike që sfidojnë partitë tradicionale. Në Shqipëri, spektri politik ka qenë i dominuar për më shumë se dy dekada nga tre parti kryesore: PS, PD dhe LSI. Duke gjykuar nga pritshmëritë, diaspora mund të jetë kritike ndaj këtyre subjekteve, duke kërkuar një ndryshim të kursit politik. Gjithashtu do të influencojë partitë të adresojnë çështje specifike që shqetësojnë shqiptarët jashtë vendit, siç janë lehtësirat për investime, shtimi i transparencës dhe fuqizimi i lidhjeve ekonomike.

¹¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. (n.d.). <https://kqz.gov.al/results/results2021/results2021.htm>

Tab 2. Të dhënat mbi grupmoshat e regjistruara deri më tani në platformën për votuesit e diasporës

Grupmosha	%
26-35 vjeç	28.8%
36-45 vjeç	27.7%

Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Këto grupmosha janë më të predispozura për të mbështetur ndryshimet dhe janë më pak të ndikuara nga polarizimi politik. Të ekspozuar ndaj zhvillimeve globale dhe informacionit të pavarur, ata shfaqen më rezistentë ndaj manipulimeve politike.

Vota e diasporës shqiptare pritet të luajë një rol të rëndësishëm në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, duke sjellë prirje dhe perspektiva të reja në skenën politike të vendit. Rritja e pjesëmarrjes së diasporës do të ndikojë në terma afatgjatë jo vetëm në përmbajtjen e rezultateve, por edhe në procesin e demokratizimit dhe zhvillimit politik të Shqipërisë. Për këtë arsye, përfshirja dhe angazhimi aktiv i diasporës duhet të inkurajohen dhe mbështeten përmes proceseve transparente dhe mirëinformuese.

b) Në terma afatshkurtër

Në terma afatshkurtër i referohemi impaktit që do të ketë vota e diasporës në zgjedhjet e ardhshme të 11 majit.

Së pari, që nga momenti i votëbesimit në parlament në muajin korrik 2024, afatet kohore kanë qenë të limituara dhe shpesh herë është vënë në pikëpyetje i gjithë procesi nëse do të arrinte të realizohej në kohë, duke kapërcyer edhe afate që janë përcaktuar nga rregullorja. Siç është afati për të filluar regjistrimin online, që nuk u hap në muaj dhjetor sipas parashikimeve, por u shty në janar. Ka pasur ndryshime të vazhdueshme dhe propozime për ndryshim, sidoemos mbi kthimin e votës së diasporës, ku ka një mospërputhje midis asaj që përcakton Kodi Zgjedhor dhe deklaratave zyrtare të instancave përgjegjëse. Të gjitha këto shkaktojnë konfuzion dhe bëjnë që votuesi gri të stepet dhe të mos shkojë të votojë, ndërsa nga ana tjetër ata të cilët janë militantë të partive politike apo ata të cilët kanë lidhje familjare mund të mobilizohen më lehtë.

Së dyti, vota e diasporës do të numërohet në qarkun ku ka qenë adresa e fundit e tij përpara largimit. Kështu, votat do të shkojnë në 12 qarqe siç janë të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.¹² Pra, diaspora nuk

¹² LIGJ Nr. 10 019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

do të ketë kuota si shumë vende të tjera, siç mund të përmendim Francën, Italinë, etj.,¹³ pra nuk do të ketë një përfaqësim të drejtpërdrejtë të tyre në parlament. Por sa impakt do të ketë kjo votë duke pasur parasysh sistemin zgjedhor shqiptar?

Reforma zgjedhore e vitit 2008 dhe versionet e saj të amenduara (2019, 2024) kanë përforcuar dominimin e dy partive kryesore, duke dëmtuar pluralizmin dhe proporcionalitetin në përfaqësimin politik. Sistemi aktual zgjedhor marginalizon partitë e vogla, sidomos në qarqe me popullsi të vogël, ku ndarja e mandateve ul ndjeshëm shanset e tyre për përfaqësim parlamentar. Kjo ka krijuar një sistem që favorizon partitë e mëdha dhe ka reduktuar numrin e partive parlamentare që nga viti 2009.

Për më tepër, partitë politike shqiptare janë bërë më të centralizuara dhe të varura nga lidhshipi, duke u karakterizuar nga mungesa e transparencës, klientelizmi dhe kufizimi i debatit të brendshëm. Sistemi i listës së mbyllur ka thelluar këtë fenomen, duke kufizuar përzgjedhjen e kandidatëve nga votuesit dhe duke e vendosur këtë proces në duart e liderëve partiakë.¹⁴

Futja e votës së diasporës, në këtë kontekst, pa krijimin e kushteve për diskurs të hapur dhe pjesëmarrje të pavarur, ky mekanizëm mund të përforcojë hierarkitë ekzistuese politike, duke kufizuar ndikimin transformues të diasporës në strukturat politike të Shqipërisë. Si rezultat, vendimet mbi këtë reformë duhet të shoqërohen me masa që garantojnë transparencë, përfshirje dhe ndarjen e drejtë të pushtetit. Së treti deri më tani, partitë politike në Shqipëri nuk kanë treguar ndonjë ndryshim domethënës në qasjen e tyre ndaj diasporës. Aktivitetet e tyre janë kufizuar kryesisht në takime me diasporën, ku sidomos Partia Socialiste ka shfaqur një prani më të madhe në këtë drejtim. Megjithatë, këto takime shpesh perceptohen si të organizuara kryesisht për qëllime propagandistike, pa një strategji të qartë për të integruar votën e diasporës apo për të përfshirë këtë komunitet në proceset e vendimmarrjes. Si rezultat, vota e diasporës deri më tani nuk ka sjellë asnjë ndikim të dukshëm në diskursin politik, në rekrutimin e profesionistëve nga diaspora apo në ofrimin e një fryme të re në arenën politike shqiptare.

¹³ Della Cooperazione Internazionale, M. D. a. E. E. (n.d.). *Voting abroad – Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale*. <https://www.esteri.it/en/servizi-consolari-e-visti/italiani-all-estero/votoestero/>

1. ¹⁴ Report.al, (2024), "Partitë e reja mbajnë sytë nga Reforma Zgjedhore"

<https://www.reporter.al/2024/05/21/partite-e-reja-mbajne-syte-nga-reforma-zgjedhore/>

Përtej të drejtës për të votuar, është thelbësore që diaspora të ketë mundësinë të kontribuojë në mënyrë reale për zhvillimin ekonomik, kulturor dhe shoqëror të vendit, si dhe për demokratizimin e mëtejshëm të tij. Diaspora përfaqëson një burim të pashfrytëzuar të njohurive, aftësive dhe përvojës që mund të sjellin transformime pozitive në Shqipëri. Megjithatë, kthimi i kësaj pjese të diasporës dhe përfshirja e saj aktive në zhvillimin e vendit kërkon një qasje të mirëorganizuar dhe gjithëpërfshirëse nga ana e shtetit shqiptar dhe shoqërisë në tërësi.

Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme që shteti shqiptar të ndërmerret hapa konkretë për të vlerësuar dhe çmuar diasporën jo vetëm në aspekt simbolik, por edhe në atë konkret. Kjo përfshin krijimin e politikave të veçanta që nxisin rikthimin e profesionistëve dhe ekspertëve nga diaspora, duke u garantuar mundësi të barabarta për të kontribuar në institucione shtetërore, në sektorin privat dhe në shoqërinë civile. Po ashtu, duhet të sigurohet një strukturë institucionale që promovon përfshirjen aktive të diasporës në proceset vendimmarrëse dhe në iniciativat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në këtë drejtim, përvoja ndërkombëtare ka treguar se suksesi i këtyre përpjekjeve lidhet ngushtë me ofrimin e stimuljeve konkrete, përfshirë mbështetjen financiare për projektet e drejtuara nga diaspora, njohjen e diplomave dhe kualifikimeve ndërkombëtare, si dhe lehtësimin e procedurave administrative për rikthimin e tyre. Vetëm përmes një qasjeje të tillë të strukturuar mund të kthejmë “brain drain” në një “brain gain,” duke e transformuar diasporën nga një burim i larguar në një aktor të fuqishëm të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë.

6. PARTITË POLITIKE NË GARË PËR VOTËN E DIASPORËS PËR ZGJEDHJET E 2025

Politika aktuale e vendit ka një ndikim të theksuar në votën e diasporës, për të cilën angazhimi i partive politike luan një rol kyç. Në vitin 2024, Kryeministri Edi Rama realizoi një seri takimesh dhe aktivitete në disa shtete të diasporës, përfshirë Greqinë, Italinë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretërinë e Bashkuar.¹⁵ Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte inkurajimi i shqiptarëve jashtë Shqipërisë për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme dhe për t'u regjistruar si votues. Angazhimi i Partisë Socialiste ka qenë mjaft i madh dhe ka sjellë një ndikim të

¹⁵ Delia-Kaci, J. (2024, May 25). Rama në turne evropian për të mbledhur mbështetje për PS-në. *Radio Evropa E Lirë*. <https://www.evropaelire.org/a/rama-turne-diaspora-shqiptare-mbledhie-votash-32946799.html/>

dukshëm në mobilizimin e diasporës, duke krijuar mundësinë e një elektorati të madh që mund të ndikojë në rezultatin e zgjedhjeve. Kjo mund të shihet si një mundësi për të formësuar drejtimin politik të vendit. Megjithatë, ky angazhim ka ngritur disa shqetësime, veçanërisht lidhur me përdorimin e fondeve publike për fushatën elektorale. Aktivitetet e Kryeministrit dhe të Partisë Socialiste janë realizuar me një kosto të lartë, duke shkaktuar kritika për transparencën në përdorimin e burimeve shtetërore, gjë që mund të ndikojë në besueshmërinë e procesit zgjedhor. Disa grupe politike dhe analistë kanë ngritur pyetje për përdorimin e këtyre fondeve për t'i dhënë përparësi një partie politike, ku me shumë mundësi ky ritëm takimesh do të vazhdojë edhe gjatë periudhës së fushatës zyrtare.

Në një mjedis politik ku propaganda dhe përzjerja e administratës publike dhe përdorimi i burimeve shtetërore luan një rol të rëndësishëm në proceset zgjedhore, të cilat mund të influencojnë votën e diasporës.¹⁶ Mungesa e informacionit të besueshëm institucional e rrezikon procesin zgjedhor, duke lejuar që votuesit e diasporës të bëhen thjesht pjesë e zgjerimeve të strukturave të partive politike si dhe mund të bien pre e strukturave "patronazhiste". Ky fenomen mund të përfshijë përdorimin e misioneve diplomatike ose konsullore, duke transformuar vullnetin e lirë.

Një tjetër faktor që mund të ndikojë në votën e diasporës është rritja e buxhetit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2025, që arrin në shifra prej 3.8 miliardë lekësh.¹⁷ Ky buxhet është më i madhi në historinë e ministrisë i cili mbështet shërbimin e jashtëm. Kjo rritje e ardhur në këtë vit zgjedhor ndërlihet drejtpërdrejt me procesin e zgjedhjeve duke nxitur dyshimin e arsyeshëm të favorizimit të një partie dhe mund të përdoret nga përfaqësitë diplomatike për të intensifikuar takimet e tyre, duke shkaktuar shqetësime për mundësinë e shkeljeve të kodit zgjedhor. Përdorimi i këtyre fondeve dhe përfshirja e diplomatëve dhe ambasadorëve në aktivitetet e Kryeministrit mund të krijojë një ndikim të padrejtë në rezultatin e zgjedhjeve.

Nga ana tjetër, opozita ka treguar një angazhim më të kufizuar në përpjekjet për të angazhuar diasporën, kryesisht për shkak të mungesës së buxhetit dhe infrastrukturës. Kjo ka pamundësuar

¹⁶ Albania's 2023 local elections: ODIHR election observation mission final report. (n.d.). OSCE.

<https://www.osce.org/odihr/elections/albania/553975>

¹⁷ Fjala e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi projekt- buxhetin e Shërbimit të Jashtëm për vitin 2025 dhe mbi procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian | General Consulate in Thessaloniki. (n.d.). <https://ambasadat.gov.al/thessaloniki-consulate/en/node/642>

zhvillimin e aktiviteteve të ngjashme me ato të Partisë Socialiste, duke bërë që pjesëmarrja e opozitës të jetë më e kufizuar. Kjo mund të krijojë një situatë të pabarabartë, ku partia në pushtet ka mundësi të angazhojë më shumë burime për të mobilizuar diasporën, ndërkohë që opozita nuk ka të njëjtën mundësi për të realizuar aktivitete të ngjashme. Kjo mund të ndikojë në formësimin e rezultatit zgjedhor dhe të krijojë mundësi për një mobilizim të njëanshëm.

Në këtë mënyrë, ndikimi i politikës aktuale në votën e diasporës është i lidhur ngushtësisht me mënyrën se si partitë politike angazhojnë këtë elektorat të rëndësishëm. Ky proces është thelbësor për rezultatet zgjedhore, por gjithashtu ka potencialin të çënojë transparencën dhe integritetin e procesit zgjedhor, duke hapur mundësi për manipulime dhe shkelje të mundshme të kodit zgjedhor. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar nga aktorët politikë dhe institucione për të siguruar një proces zgjedhor të ndershëm dhe të besueshëm.

Vota e diasporës në zgjedhjet e majit mbetet e kufizuar për shkak të faktorëve të përmendur më sipër. Megjithatë, nëse do të ketë një reflektim serioz nga partitë politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe opinioni publik, ekziston potenciali për rezultate më të dukshme në zgjedhjet parlamentare pasardhëse të 2029.

7. GJETJET KRYESORE

- 1. Të dhëna për diasporën:** Me rreth 1,6 milion shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, diaspora përfaqëson një elektorat të konsiderueshëm dhe përfshirja e saj në zgjedhje është një e drejtë kushtetuese që duhet garantuar
- 2. Kontributet Ekonomike:** Diaspora ka ndihmuar ekonominë shqiptare përmes remitancave, të cilat kanë luajtur një rol jetësor në stabilizimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për shumë familje.
- 3. Potenciali i lartë i pjesëmarrjes së diasporës:** Nëse ritmi aktual i regjistrimeve të votuesve nga diaspora vazhdon, numri i votuesve të regjistruar pritet të arrijë mbi 300,000, një shifër që mund të sjellë ndryshime rrënjësore në sistemin politik shqiptar, gjithmonë nëse procesi është i lirë nga influencat dhe manipulimet politike.
- 4. Efektet afatgjata pozitive:** Vota e diasporës pritet të ndikojë në emancipimin dhe modernizimin e sistemit zgjedhor, duke sjellë përmirësime të vazhdueshme në Kodin Zgjedhor dhe përgatitjen



**VOTA E DIASPORËS:
KUTIA E PANDORËS?**

e aktorëve të përfshirë për zgjedhjet e pasardhëse, si ato të vitit 2029.

5. Kontribut në demokratizim dhe zhvillim politik: Angazhimi aktiv i diasporës, i mbështetur nga procese transparente dhe të informuara, do të kontribuojë në demokratizimin dhe zhvillimin afatgjatë të Shqipërisë.

6. Kufizimet në planin afatshkurtër:

- Vonesa në procesin e regjistrimit dhe zbatimin e afateve do të ndikoj negativisht në përfshirjen e plotë të diasporës në zgjedhjet e ardhshme.
- Sistemi zgjedhor aktual, me centralizimin e tij dhe listat e mbyllura, favorizon partitë e mëdha dhe pengon përfaqësimin e drejtpërdrejtë të diasporës në parlament.
- Mungesa e një qasjeje konkrete të partive politike ndaj diasporës ka kufizuar ndikimin e saj në politikën shqiptare.

8. REKOMANDIME

1. Ndryshimi i Kodit Zgjedhor për Kthimin e Votës së Diasporës:

Aktualisht, Kodi Zgjedhor përcakton që votuesit në diasporë duhet të mbulojnë vetë shpenzimet për kthimin e votës, ndërkohë që KQZ ka deklaruar se shteti do ta mbulojë këtë kostot. Për të reflektuar këtë angazhim, është e nevojshme që Kodi Zgjedhor të ndryshohet për të përcaktuar qartë se shteti shqiptar do të mbulojë shpenzimet e kthimit të votës për diasporën, duke siguruar një pjesëmarrje të barabartë dhe të pa penguar në zgjedhje.

2. Monitorimi i Buxhetit Shtetëror dhe i Administratës në Fushatën Zgjedhore për Diasporën:

Të krijohet një mekanizëm transparent për monitorimin e mënyrës se si përdoret buxheti shtetëror dhe burimet administrative gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, veçanërisht për aktivitete që kanë të bëjnë me diasporën. Ky monitorim duhet të përfshijë vlerësimin e shpenzimeve për promovimin e fushatave zgjedhore në diasporë dhe mënyrën se si administrata shtetërore dhe diplomatike përdoren për të angazhuar votuesit jashtë vendit.

3. Reflektimi i Diasporës në Programet dhe Diskursin Politik, dhe Pjesëmarrja e Tyre në Listat Elektorale:

Duhet të reflektohen në mënyrë konkrete nevojat dhe interesat e diasporës në



programet zgjedhore të partive politike dhe në diskursin politik të Shqipërisë. Partitë politike duhet të përfshijnë çështjet e diasporës në programet e tyre, duke adresuar shqetësimet e saj dhe duke garantuar mundësi për të ndikuar në vendimmarrje. Gjithashtu, duhet të krijohen mundësi të qarta dhe të drejtpërdrejta për diasporën që të përfshihet në listat elektorale, duke siguruar përfaqësim të drejtpërdrejtë në Kuvendin e Shqipërisë. Ky hap do të forconte lidhjen e diasporës me Shqipërinë dhe do të risë ndikimin e saj në zhvillimin e politikave të vendit.

4. Krijimi i Zonës së 13-të Zgjedhore për Diasporën: Është e domosdoshme krijimi i një zone të veçantë zgjedhore për diasporën, që do t'i mundësonte përfaqësim të drejtpërdrejtë në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo do të siguronte që zëri i diasporës të dëgjohet dhe të marrë pjesë aktive në vendimmarrje.

5. Nevoja për politika konkrete ndaj diasporës:

- o Është e domosdoshme që shteti shqiptar të ndërmarrë hapa konkretë për të integruar dhe vlerësuar diasporën, duke krijuar politika që promovojnë rikthimin e profesionistëve dhe mundësi të barabarta për kontributin e tyre.
- o Partitë politike duhet të përfshijnë çështjet e diasporës në programet e tyre dhe të sigurojnë përfaqësim të drejtpërdrejtë të saj në Kuvend, duke forcuar lidhjen mes diasporës dhe Shqipërisë.

6. Përmirësimi i diskursit politik: Adresimi i shqetësimeve dhe interesave të diasporës në diskursin politik dhe programet zgjedhore do të garantojë një lidhje më të fortë dhe ndikim më të madh të diasporës në politikat publike të vendit.



9. REFERENCA

- Albania's 2023 local elections: ODIHR election observation mission final report. (n.d.). OSCE. <https://www.osce.org/odihr/elections/albania/553975>
- Delia-Kaci, J. (2024, May 25). Rama në turne evropian për të mbledhur mbështetje për PS-në. *Radio Evropa E Lirë*.
<https://www.evropaelire.org/a/rama-turne-diaspora-shqiptare-mbledhje-votash-/32946799.html/>
- Della Cooperazione Internazionale, M. D. a. E. E. (n.d.). *Voting abroad – Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale*.
<https://www.esteri.it/en/servizi-consolari-e-visti/italiani-all-estero/votoestero/>
- Fjala e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi projekt- buxhetin e Shërbimit të Jashtëm për vitin 2025 dhe mbi procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian | General Consulate in Thessaloniki. (n.d.).
<https://ambasadat.gov.al/thessaloniki-consulate/en/node/642>
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. (n.d.).
<https://kqz.gov.al/results/results2021/results2021.htm>
- KQZ. (2023, April 3). *Rregullat për Votimin nga Jashtë - KQZ*. KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. <https://kqz.gov.al/rregullat-per-votimin-nga-jashte/>
- Popullsia. (n.d.). Instat. <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>
- Progress, C. (n.d.). QBZ - Qendra e Botimeve Zyrtare.
<https://qbz.gov.al/preview/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>
- RedaksiaLexo. (2024, November 24). *Live/ Turi me diasporën, gati takimi i Ramës me shqiptarët e Londrës, salla me mbi 7 mijë vende*. [www.lexo.al](https://lexo.al/2024/11/live-turi-me-diasporen-gati-takimi-i-rames-me-shqiptaret-e-londres-salla-me-mbi-7-mije-vende).
<https://lexo.al/2024/11/live-turi-me-diasporen-gati-takimi-i-rames-me-shqiptaret-e-londres-salla-me-mbi-7-mije-vende>
- Speciale/ Zgjedhjet 2025, ja si do regjistrohet një emigrant për të votuar! Celibashi për Report Tv: Qeveria 5 mln euro për të paguar postën, por duhet ndryshuar Kodi. (2025, January 2). *Shqiptarja.com*.
<https://shqiptarja.com/index.php/lajm/speciale-zgjedhjet-2025-hap-pas-hapi-si-te-regjistrohet-nje-emigrant-per-te-votuar-celibashi-per-report-tv-nuk-do-paguajne-asnje-kosto>
- Statistikat e Përdorimit. (n.d.). <https://kqz.al/stats/>
- TRADING ECONOMICS. (n.d.). *Albania remittances*.
<https://tradingeconomics.com/albania/remittances#:~:text=Remittances%20in%20Albania%20decreased%20to,the%20second%20quarter%20of%202024.>
- Zgjedhjet parlamentare 2025 do të mbahen më 11 maj! Presidenti Bajram Begaj dekreton datën: E nevojshme për të mundësuar votën e diasporës. (2024, December 5). *Shqiptarja.com*. <https://shqiptarja.com/lajm/zgjedhjet-parlamentare-2025-presidenti-begaj-dekreton-daten-11-maj>

**VOTA E DIASPORËS:
KUTIA E PANDORËS?**

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al